



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

1. Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas konkursit nr.05/295 të datës 15.06.2022, për ndarjen e bursave për Studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2021-2022, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|----------------------------|--|
| 1. Selman Gashi, | kryesues, zyrtar për çështje pedagogjike – Drejtorja e Arsimit. |
| 2. Mehmet Kastrati, | anëtar, zyrtar i lartë për buxhet dhe financa - Drejtorja e Arsimit. |
| 3. Tafil Thaçi, | anëtar, nga jashtë. |

Neni 2


Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Arsimit
Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-0053307/22
Podujevë, datë 01.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Komisioni për vlerësimin dhe pranimin e projektit: “ Podujeva për Eficiencë dhe Zhvillim Efikas” në vlerë prej 111,113.86 €, projekt sipas të cilit Komuna e Podujevës është përfituese në “ Programin komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër komunal, i quajtur si program IIK-CIF (Instrumenti i investimeve Kapitale -2), në këtë përbërje:

Veton Aliu, kryesues
Afrim Mulliqi, anëtar
Genc Gashi, anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi do të vlerësojë dhe do të bëjë pranimin detal të projektit të cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:
Anëtarëve të komisionit
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/04-0053420/22
Podujevë, datë: 01.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

1.Hapësira në pjesën e përparme brenda oborrit të ndërtesës së re të Komunës lejohet për shfrytëzim të parkingut të automjeteve me targa të huaja nga bashkatdhetarët të cilët qëndrojnë për pushime në Komunën e Podujevës, dhe jo vetëm.

2.Hapësira lejohet për shfrytëzim 24 orë dhe atë pa pagesë.

Neni 2


Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Administratës e cila organizon dhe cakton personelin përkatës për mbarëvajtjen e procesit sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi më 01.07.2022 dhe vlen deri më 31.08.2022.

U dërgohet:
Drejtorisë së Administratës
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
QSHQ/Arkivit

Nr.prot.02-01601-0055569/22
Podujevë, datë: 01.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.3 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR MBIKQYRJEN DHE PËRCJELLJEN E FUSHATËS PËR KORRJE-SHIRJE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2022

Neni 1

Ngritet Komisioni komunal për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e fushatës për korrje-shirje në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2022, në përbërje:

1. Behë Govori- nga Drejtoria e Bujqësisë Pyllatrisë dhe Zhvillimit Rural, kryesues
2. Ilaz Hoti- nga Shërbimi i Zjarrfikësve, anëtar
3. Eset Abdullahu- nga Drejtoria e Inspeksionit, anëtar

Neni 2

Komisioni bën mbikëqyrjen dhe kujdeset për mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni në formë të shkruar informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorit të DBPZHR
Zyrës së Informimit
QSHQ/ Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0053573/22
Podujevë, datë: 01.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 9 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, ngrihet Komisioni me madat dy vjeçar në këtë përbërje:

Mirlinda Arifi,
Vahide Veseli,
Fitore Blakçori,
Genc Gashi,
Besime Veliu,

kryesuese - *Drejtorja e Arsimit.*
anëtare - *Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.*
anëtare - *Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mëirëqenjes Sociale.*
anëtar - *Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.*
anëtare - *Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit.*

Neni 2


Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorive përkatëse
Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-0054229/22
Podujevë, datë 04.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VEÇANTË PËR RASTET DHE KËRKESAT INDIVIDUALE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për rastet dhe kërkesat individuale të cilat paraqiten jashtë thirrjeve publike, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Makfirete Zeka,	kryesuese - <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.</i>
Blerim Vllasa,	anëtar - <i>Drejtorja e Arsimit.</i>
Hamide Aliu,	anëtare - <i>Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.</i>
Memli Gashi,	anëtar - <i>Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.</i>
Venoza Zullufi,	anëtare - <i>Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit.</i>

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

*U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Arsimit
Arkivit*

Nr. Prot 02-020/01-0054227/22
Podujevë, datë 04.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b), c) dhe g), ndërlidhur me nenin 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2) 1.3) dhe 1.7) ndërlidhur me nenin 64 paragrafët 3 dhe 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës së Podujevës, që në emër të Komunës, të nënshkruaj;

- Memorandum Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi me Organizatën ECOKOSWOMEN, për ndarjen e përgjegjësiive për zbatimin e projektit “ Fuqizimi ekonomik i grave, krijimi i vendeve të punës dhe prosperiteti më i mirë përmes angazhimit në bujqësi, dhe
- Memorandum Bashkëpunimi me OJQ Lady, për përcaktimin e bazave të bashkëpunimit në mes të OJQ Lady dhe Komunës së Podujevës;

Bashkëngjitur: Draftet përkatëse të Memorandumeve.

U dërgohet:

- Nënkyetares së Komunës
- QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0054631/22
Podujevë, datë: 05.07.2022



Kryetari Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 27 paragrafi 1. 10 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0054073/22, të datës 04.07.2022, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Gani Hamza nga Podujeva, përkrahet me mjete financiare në shumë 200€ për pjesëmarrje në festivalin e përvitshëm “Skena Verore-Ulqin”, në cilësinë e artistit në monodramën “Hamleti”.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet: Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.
Përfituesit të subvencionit.
QSHQ/Arkivit.*

Nr.prot 02-400/03-0055464/22
Podujevë, datë, 07.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpëtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr;

V E N D I M

Neni 1

Për arritjen e standardeve të larta të qeverisjes lokale, të matura me parimet e qeverisjes së mirë demokratike të krijuara nga Qendra e Ekspertizës për qeverisje të mirë, sipas projektit-Çmimi Evropian i Ekselencës në Qeverisje (ELOGE) në Kosovë, projekt i financuar nga Këshilli i Evropës, ngritet Ekipi komunal në këtë përbërje:

Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, *koordinatore e Ekipit*
Ejup Babatinca, *udhëheqës i Sektorit të Planifikimit, Parimi: Efikasiteti dhe Efektiviteti*
Fitim Bunjaku, *menaxher i Personelit, Parimi: Kompetencë dhe Kapacitet*
Faik Rama, *përfaqësues i Komunës për konteste juridike, Parimi: sundimi i ligjit*
Haxhere Ajvazi, *shefe e Thesarit, Parimi: Menaxhimi i Shëndoshë Financiar*
Sabedin Namani, *udhëheqës i Sektorit Ligjor, Parimi: Llogaridhënia*
Enis Sheholli, *zyrtar i lartë ligjor, Parimi: Përgjegjshmëria*
Naime Podvorica, *zyrtare e lartë për koordinimin e të drejtave të njeriut Parimi: Të Drejtat e Njeriut, Diversiteti kulturor dhe Kohezioni Shoqëror*
Liridona Rrahmani, *zyrtare për informim dhe monitorim të mediave, Parimi: Hapja dhe Transparenca*
Jehona Havolli, *zyrtare e Personelit, Parimi: Sjellja Etike*
Xhyfidane Nimani, *zyrtare e Teknologjisë Informative, Parimet: Inovacion dhe hapje për Ndryshim Parimi; Qëndrueshmëria dhe Orientimi Afatgjatë*

Neni 2

Ekipi sipas nenit 1 të këtij Vendimi do të angazhohet për zhvillimin e aktiviteteve në funksion të zbatimit të Parimeve të cekura mbi vetëdijesimin e cilësisë së shërbimeve publike të krijuara sipas standardeve të qeverisjes së mirë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Të emëruarve
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/04-0055710/22
Podujevë, datë: 08.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0055618/22, të datës 08.07.2022, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Fatmir Xhela nga fshati Brainë, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të nipit të tij Dorjet Xhela dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
z.Fatmir Xhela.
QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-400/04-0056536/22
Podujevë, datë, 12.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-550/01-0053323/22, të datës 01.07.2022, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Ali Kosumi nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të fëmijës së tij Driti Kosumi dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.


z.Ali Kosumi.

QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-400/04-0056540/22
Podujevë, datë, 12.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.02-400/04-0056363/22 të datës 12.07.2022 të OJQ - Klubi i Gollbollit Llapi-KGLL, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - KLUBI I GOLLBOLLIT LLAPI -KGLL

Neni 1

OJQ - Klubi i Gollbollit Llapi-KGLL, për blerjen e pajisjeve sportive mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ - Klubi i Peshkatarëve Sportiv Recreativ të personave me aftësi të kufizuara “Llapi” Podujevë.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/04-0056363/22
Podujevë, datë 12.07.2022



**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr.prot.02-020/04-0053307/22, i datës 01.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas konkursit nr.05/295 të datës 15.06.2022, për ndarjen e bursave për Studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2021-2022, dhe atë:

z.Ardian Emini zyrtar financiar SMIA- Drejtoria e Arsimit caktohet në vend të **z.Mehmet Kastrati** i cili zëvendësohet për shkak të shkuarjes në punë dhe detyra tjera të punës.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërse e vendimit nr.prot.02-020/04-0053307/22, të datës 01.07.2022.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Arsimit
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot 02-016/01-0057830/22
Podujevë, datë 15/07/2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe konform Ftesës Publike të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, të publikuar më 29.06.2022, nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e shtëpizave të drurit sipas Ftesës Publike të DPZHE për projektin “**Ditët e Diasporës**” që ka për qëllim rritjen e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për qytetarët e Komunës së Podujevës me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve gjatë sezonit të verës, ngritet komisioni në përbërje:

1. Genc Gashi, kryesues
2. Mimoza Restelica, anëtare
3. Memli Gashi, anëtar

Neni 2

Komisioni, bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe përzgjedhjen e aplinaktëve / bizneseve që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në shtëpizat e drurit në Sheshin e Qytetit “Ali Ajeti”, sipas projektit të publikuar me Ftesën Publike.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0057837/22
Podujevë, datë: 15.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, datë 15 07. 2022, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "EMIN DURAKU" NË FSHATIN BAJQINË KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Bashkim Lepaja, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted], nga fshati Bajqinë, Komuna e Podujevës, i kualifikuar *profesor i Biologjisë*,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Emin Duraku" në fshatin Bajqinë, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtoria e Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0058885/22
Podujevë, datë: 18.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Xhevrie Beqiri, zyrtare për kthim të qëndrueshëm në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, krahas punëve dhe detyrave nga pozita sipas akt-emërimit, caktohet edhe në cilësinë e zyrtares përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi në kuadër të institucioneve të Komunës.

Neni 2

E përmendura, sipas këtij vendimi, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fuqi dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse do të koordinojë punët dhe aktivitetet si dhe do të raportoj dhe bashkëpunojë me mekanizmat relevantë institucional, përfshirë Zyrën për Qeverisje të Mirë/ZKM.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E caktuara
Institucionet komunale
QSHQA/Arkiva

Nr.prot. 02-020/02-0058883/22
Podujevë, datë: 18.07.2022



Kryetari i Komunës
Shefqim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, datë 15 07. 2022, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "SHABAN SHALA" NË PODUJEVË

Neni 1

znj. Aisela Uka, me nr. personal të letërnjoftimit 15722022, me vendbanim në Podujevë, e kualifikuar *mësuese e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe*,

Emërohet përkohësisht në pozitën Zëvendës Drejtoreshë e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët- SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë.

Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e zëvendës Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*Idërgohet:
Drejtoria e Arsimit
Të emëruarës
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-020/02-0058894/22
Podujevë, datë: 19.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.02-400/04-0058365/22 të datës 18.07.2022 të OJQ – Qendra Sportive Rekreative Kroni - Q.S.R.Kroni, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ – QENDRA SPORTIVE REKREATIVE KRONI-Q.S.R.KRONI

Neni 1

OJQ–Qendra Sportive Rekreative Kroni-Q.S.R.Kroni, për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare të kickboxit të organizuara nga FNC Armagedon-Fighting Nations Championship në Zabok të Kroacisë mbështetet me mjete financiare në shumë 400.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ – Qendra Sportive Rekreative Kroni- Q.S.R.Kroni.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0059316/22
Podujevë, datë 19.07.2022



**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 27 paragrafi 1.3 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, sipas kërkesës nr.prot. 02-400/04-0058762/22, të datës 18.07.2022, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Riad Aliu nga Podujeva, për organizimin e garës sportive “Streetball Podujeva 2022” që zhvillohet në Bulevardin e Qytetit, për nder të Javës së Diasporës, mbështetet me mjete financiare në shumë 450.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorive përkatëse
Z,Riad Aliu
QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-400/04-0060469/22
Podujevë, datë, 22.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat (b,g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj. Qendresa Shala, zyrtare certifikuese në kuadër të Drejtorisë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, autorizohet për certifikimin e pagesave të lëndëve financiare në SIMFK.

Neni 2

Autorizimi i të përmendurës bëhet për kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara që kanë të bëjnë dhe ndërlihen me pozitën e zyrtarit certifikues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtorja e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
Të caktuarës
DBF dhe Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0060454/22
Podujevë, datë: 22.07.2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.02-334/07-0060142/22 të datës 22.07.2022 të OJQ – Lady, proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ – LADY

Neni 1

OJQ–Lady, për organizimin e panairit më datë 1 dhe 2 gusht 2022 në Sheshin e Qytetit të Podujevës që gratë dhe vajzat e Komunës së Podujevës të kenë mundësi t'i prezantojnë dhe shesin produktet e tyre, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë Marrëveshje/kontratë me përfituesin e projektit duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ – Lady.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/04-0060473/22
Podujevë, datë 22.07.2022



**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve rinore/ kulturore, datë 13.07.2022, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE-OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ, për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore, sipas Thirrjes publike dt. 07.04.2022, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **10,400.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore/rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0061006/22
Podujevë, date: 25.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

Për: